

KLSH nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me Gjykatën e Llogarive të Rumanisë

Më datën 18 shtator 2018, në Bukuresht të Rumanisë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj nënshkroi rinovimin e Marrëveshjes dhe Planin e Bashkëpunimit për aktivitete të përbashkëta 2018-2021 mes Gjykatës së Llogarive të Rumanisë dhe KLSH-së. Presidenti i Gjykatës, z. Mihai Busuioc vlerësoi këtë marrëveshje si të rëndësishme për institucionin e tij dhe objektivat e tij reformuese, pas marrjes së detyrës një vit më parë nga Parlamenti rumun. Ai u shpreh se për institucionin shqiptar të auditimit të jashtëm publik kishte marrë opinion tejet pozitiv nga Presidenti i Gjykatës së Llogarive të Portugalisë dhe ish-President i Gjykatës Evropiane të Audituesve(ECA), Dr. Vitor Caldeira dhe theksoi se *“me nisma konkrete do të zhvillojmë vullnetin tonë për punë të përbashkët, punë që do të sjellë vlerë të shtuar për audituesit e dy SAI-ve tona”*.

Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj dhe Presidenti i Gjykatës Rumune të Llogarive, z.Mihai Busuioc nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi. Bukuresht, 18 shtator 2018.

Kryetari Leskaj u shpreh se, bazuar në moton e INTOSAI-t *“Experientia mutua Omnibus prodest (Nga eksperiencia e përbashkët fitojnë të gjithë)”* dhe në Nenin 15 *“Shkëmbimi ndërkombëtar i eksperiencave” të Deklaratës së Limës, ISSAI 1*, *“ Po nënshkruajmë këtë Marrëveshje dhe Plan të përbashkët Veprimi për disa arsye themelore.*

Së pari, për shkak të lidhjeve historike mes popujve tanë, popullit shqiptar dhe popullit mik rumun, në këtë vit të krenimit të 100 Vjetorit të Bashkimit të Rumanisë, së cilës i jemi mirënjohës se ka mirëpritur dhe mbajtur në gjirin e saj patriotët shqiptarë gjatë viteve 1890-1912, në përpjekjet e tyre të pareshtura për liri, që kulmuan me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimin e Shtetit shqiptar në vitin 1912.

Së dyti, nënshkruajmë bashkëpunimin në vlerësim të personalitetit të fuqishëm reformues të z. Mihai Busuioc, President i Gjykatës së Llogarive të Romanisë. Ne kemi shumë për të mesuar nga Gjykata e Llogarive e Rumanisë, një SAI i madh evropian dhe me tradita. Besojmë se shkëmbimi i eksperiencave më të mira në auditim do të kontribuojë në zhvillimin dhe modernizimin e mëtejshëm të institucioneve tona”.

Gjatë vizitës në Rumani, Kryetari i KLSH u prit nga Kryeministrja e Rumanisë, zj. Viorica Dăncilă në zyrën e saj të punës. Zj. Dăncilă theksoi se bashkëpunimi mes dy vendeve mike, Shqipërisë dhe Rumanisë është me rëndësi për bashkëpunimin ballkanik dhe integrimin e plotë të vendeve të rajonit në familjen e madhe evropiane. *“Në këtë drejtim”*, cilësoi Kryeministrja Rumune , *”partneriteti mes të dyja institucioneve supreme të auditimit luan një rol parësor”*.

Nga ana e tij, z. Leskaj, pasi i shprehu Kryeministres së Rumanisë mirënjohjen për ndihmën që populli rumun dhe qeveritë e tij i kanë dhënë përpjekjeve të popullit shqiptar për të formuar shtetin e tij të pavarur, nënvizoi se shkëmbimi i eksperiencave në fushën e auditimit të jashtëm publik ndikon në forcimin e besimit të qytetarit në qeverisjen publike.

Më datën 19 shtator 2018, Kryetari i KLSH u prit në Parlamentin rumun nga Marius-Constantin Budăi, Kryetar i Komisionit për Buxhetin, Financat dhe Bankat. Në përshëndetjen e tij, Kryetari Budăi vlerësoi partneritetin e Komisionit që drejton me Gjykatën e Llogarive të

Rumanisë, partneritet i cili realizohet nëpërmjet nën-komisionit të dedikuar për mbikqyrjen e punës së Gjykatës dhe vuri në dukje pritshmëritë e larta të Parlamentit ndaj qasjes së re të Presidentit të SAI-t, të përqëndruar në planin këshillues ndaj institucioneve shtetërore dhe në auditimet parandaluese ndaj dukurive të keqmenaxhimit të aseteve dhe parasë publike. Ai u interesua të dinte për raportet e KLSH me Parlamentin dhe komisionin përkatës parlamentar në Shqipëri.

Në përgjigje të interesimit, z. Leskaj theksoi mbështetjen e dhënë nga Kuvendi i Shqipërisë në miratimin e ligjit integral të institucionit që drejton në fund të vitit 2014, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, si dhe rolin e Kryetarit të Komisionit të Kuvendit për Ekonominë dhe Financat në promovimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimeve të KLSH dhe nxitjen e auditimeve të reja më cilësore dhe më pranë interesave të qytetarit.

Duke vlerësuar maksimalisht idetë dhe përpjekjet reformuese të z. Mihai Busuioc, President i Gjykatës së Llogarive të Rumanisë, Kryetari i KLSH u shpreh se “...që këto ide të realizohen, ndihma dhe mbështetja Juaj si Komision është vendimtare”.

Në diskutimet për Planin e përbashkët të Veprimeve për konkretizimin e Marrëveshjes, nga SAI rumun ishin të pranishëm z. Florin Demian, Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës, zj. Marina Aulona Pelea, Anëtare e Gjykatës së Llogarive, z. Dragos Budulac, Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe z. Dimitru Nichita, Këshilltar i Presidentit të Gjykatës.

Në prezantimin e tij, Presidenti Busuioc theksoi domosdoshmërinë që Gjykata t’i largohet pozicionit që ka mbajtur deri tani si një institucion vetëm sanksionues dhe të zëvendësojë qasjen se kush jep sanksione më të rënda e ka kryer punën e tij si auditues më mirë, për të marrë një pozicion më këshillues dhe rekomandues, duke synuar auditime parandaluese ndaj riskut të keqmenaxhimit në administratën shtetërore. “*Administrata ka frikë nga ne se mos gabon dhe e ndëshkojmë dhe nuk kryen tendera. Kjo pengon zhvillimin. Ne duhet të këshillojmë qeverinë në marrjen e politikave të duhura. Duhet të jemi një hap përpara, për ta ndihmuar. Vetëm kështu mund të shndërrohemi në faktor nxitës të zhvillimit ekonomik*”, e shpreh Busuioc.

Nga ana e tij, Kryetari Leskaj, pasi prezantoi punën dhe arritjet e KLSH në periudhën 2012-2018, nënvizoi se vetëm njohja dhe asimilimi nga audituesit i standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t, ISSAI-t, ballafaqimi i eksperiencave të tyre audituese me ato të kolegëve të SAI-ve evropiane më të zhvilluara, do të mundësojë rritjen e impaktit të gjetjeve dhe rekomandimeve të SAI-t në jetën e qytetarëve.

Në përbërjen e delegacionit të KLSH ishin Prof. Dr. Skënder Osmani, ekspert i jashtëm i KLSH dhe një nga personalitetet më të spikatura të shkencës shqiptare në studimet për matematikën dhe informatikën dhe aplikimet e tyre në shoqëri dhe ekonomi, z. Muhamed Kavaja, auditues me eksperiencë mbi 25 vjetare në KLSH dhe Kryetar i Shoqatës së Audituesve të Shqipërisë dhe z. Fatos Cocoli, ekspert i jashtëm.

Marrëveshja me SAI-n e Rumanisë është e 17-ta me SAI-t evropiane simotra që KLSH ka nënshkruar gjatë viteve 2012-2018, duke zgjedhur qasjen e partneritetit të plotë dhe bashkëpunimit konkret e reciprok me institucionet e zhvilluara të auditimit suprem evropian.

